



**ZYRA E PROKURIMIT**

**Nr.006/2023**

**Nr. Protokolli: 10/2023**

<b>Për:</b>	N.P.N. HIDROTERM SH.P.K. Brigada 123, 23000, Suhareke
<b>Kopje:</b>	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
<b>Nga:</b>	Fatos Kuqi Shef i zyrës së Prokurimit
<b>Lënda:</b>	VENDIM
<b>Datë:</b>	16.02.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, **Kerkeses për Rishqyrtim** të derguar në Platforme Elektronike të datë: **13.02.2023** të parashtruar nga " .N.P.N. HIDROTERM SH.P.K. Brigada 123, 23000, Suhareke lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ndërtimi dhe rregullimi Kolektorit në rrugën Skenderbeu - Suharekë-ritrnder me Nr. të Prokurimi: 624-22-8920-5-1-1 & 624-022-053-511 nxjerr këtë

**V E N D I M**

- I. Aprovohet Pjesërisht kërkesa për ri-shqyrtim e datës 13.02.2023 të parashtruar nga grupi i operatori ekonomik për Ndërtimi dhe rregullimi Kolektorit në rrugën Skenderbeu - Suharekë-ritrnder me Nr. të Prokurimi: 624-22-8920-5-1-1 & 624-022-053-511**
- II. Anullohet njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 09.02.2023 dhe lënda kthehet në ri-vlerësim**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.**

## Ar sy e t i m

IV. Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë **13.02.2023** ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim nga Operatori Ekonomik . N.P.N. **HIDROTERM SH.P.K, Brigada 123, 23000, Suhareke** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi dhe rregullimi Kolektorit në rrugën Skenderbeu - Suharekë-ritrnder** me Nr. të Prokurimi: **624-22-8920-5-1-1 & 624-022-053-511**

Pas verifikimit të të dhënave në lidhje me pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për ri-shqyrtim nga ana juaj, ne kemi konstatuar se:

Pretendimi ankimor me nr. 1 i Kërkesës për ri-shqyrtim sa i përket qasjes në dokumente zyrtare **nuk qëndron**, ngase Autoriteti Kontraktues ka ofruar qasje në të gjitha dokumentet **që nuk janë klasifikuar nga Operatori Ekonomik si konfidenciale**. Dokumentet e kërkuara nga Operatori Ekonomik që të mbesin si sekrete afariste (konfidenciale) nuk guxojn të shpalosën në asnjë mënyrë para asnjërës pale e cila kërkon qasje në dokumente. Autoriteti Kontraktues **mos shpalosjën** e dokumenteve të kërkuara nga Operatori Ekonomik që të mbesin konfidenciale për të gjitha palët e ka bazuar në nenin **11 paragrafi 3, 3.1, 3.2 dhe 3.3** të LPP-ës dhe në nenin 7 të Rregullave për Prokurim Publik i cili përcakton si në vijim citoi:

*7.5" Informacionet të cilat mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste janë:*

- a. informacionet në lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP-se; dhe*
- b. informacionet në lidhje me mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i LPP-se.*

*7.6 Informacionet mund të klasifikohen si konfidenciale vetëm nëse:*

*a. Operatori Ekonomik, përveç se i identifikon ("markon") dokumentet si "sekret afarist" gjatë ngarkimit të tyre në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik, i njëjti duhet të plotësojë Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit "Kërkesa për sekret afarist".*

*b. Nëse Operatori Ekonomik konsideron që informatat e dorëzuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së të trajtohen nga Autoriteti Kontraktues si informata sekrete afariste në përputhje me nenin 11 të LPP-së, i njëjti duhet të shkarkojë nga sistemi Aneksin 3 "Kërkesa për sekret afarist", të plotësojë duke dhënë arsyetimet për secilin dokument të identifikuar si "sekret afarist", nënshkruaj dhe vulos aneksin, si dhe ta ngarkojë në sistem së bashku me dokumentet tjera të tenderit të tij.*

*7.7 Është përgjegjësi e AK-së për të siguruar që pjesët të cilat janë deklaruar si sekret afarist nuk janë vënë në dispozicion Operatorëve të tjerë ekonomik".*

Gjithashtu për Autoritetin Kontraktues është e quditëshme citimi i nenit 3 të LPP-ës, nga ana juaj duke pasur parasysh që neni 3 nuk ka fare të bëjë me këtë aktivitet të Prokurimit

Neni 3 I LPP-ës flet për Përfashtime të procedurave të prokurimit, pra për procedurat që udhëhiqen nga AK duke përfashtuar Ligjin e Prokurimit Publik.

**Ndërsa sa i përket pretendimeve tjera ankimore të parashtruara nga ana juaj, Autoriteti Kontraktues do ti marr parasysh duke e kthyer lëndën edhe një here në ri-vlerësim.**

Pra bazuar në të dhënat e lartë përmendura Autoriteti Kontraktues konsideron se Kërkesa juaj është pjesërisht e bazuar dhe ky aktivitet i Prokurimit do kthehet në ri-vlerësim.

**Bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

**Shef i zyrës së Prokurimit**  
**Fatos Kuqi**

